



Informatat mbi projektin

Emri i Projektit:	Fuqizimi Ekonomik i Gruas, Avancim i Shoqëris Kosovare
Vlera e projektit:	€17,290 Bashkë financimi €13,422
Kohëzgjatja:	Fillimi: 03/10/2016 Përfundimi: 30/09/2017
Organizata:	Kosovo Center for Business Support (KCBS)
Kontaktet e Organizatë (adresa, e-maili, telefonat):	Info@kcbs-ks.org , +381(0)38 609-425 Pashko Vasa, 22, Pejton, Prishtinë
Përfituesit e drejtëpërdrejtë:	Grupet e targetuara: Përfitues kryesor të këtij projekti janë qytetaret e Gjilanit, femrat që drejtojnë dhe janë pronare të biznesëve, Komuna e Gjilanit si institucion dhe organizatat që merren me çështjet e grave. Përfitues kryesorë janë: Komuna e Gjilanit, qytetarët e saj si dhe femrat të cilat kanë biznese dhe udhëheqin këto biznese.
Partnerët:	Projekti "Fuqizimi Ekonomik i Gruas, Avancim i Shoqëris Kosovare" partner gjatë zbatimit të projektit do këtë Komunën e Gjilanit, OJQtë lokale që merren me çështjet e grave si dhe Qëndren e Biznesit të komunës së Gjilanit.
Territori i synuar/shtrirja geografike:	Projekti ynë do të zbatohet në komunën e Gjilanit dhe fshatrat e saj.
Qëllimi i përgjithshëm:	Projekti "Fuqizimi Ekonomik i Gruas, Avancim i Shoqërisë Kosovare" ka për qëllim, fuqizimin socio-ekonomik të gruas afariste në komunën e Gjilanit, përmes edukimit dhe angazhimit të saj në vendimmarrje lokale me qëllim të krijimit të politikave lokale në favor të bizneseve në përgjithësi.
Aktivitetet kryesore:	<ol style="list-style-type: none"> Mbajtja e një takimi informues në Komunën e Gjilanit lidhur me projektin, qëllimin dhe aktivitetet e projektit I cili ka të bëjë me fuqizimin e rolit të gruas në zhvillimin e komunes; Mbajtja e takimeve me gratë në biznes dhe identifikimi i çështjeve me të cilat ballafaqohen ato; Takime me institucionet lokale dhe organizata të grave lidhur me pozitën e saj në biznes; Krijimi i rrjetit joformal avokues i grave në biznes; Trajnimet për avokim dhe përpilimin e projekt-propozimeve; Krijimi i një grupi punues me pjesëtarë të komunës, shoqërisë civile, rrjetit joformal të grave në biznes, të cilët do të kontribuojnë për përpilimin e draft strategjisë; Përgatitja e projekt-propozimit dhe procedimi i strategjisë në Kuvendin Komunal të Gjilanit.
Rezultatet e pritura:	<ol style="list-style-type: none"> Vetëdijesimi i grave afariste për rëndësinë dhe kontributin e tyre në zhvillimin e shoqërisë; Rritja e ndikimit të grave në biznes përmes krijimit të rrjetit joformal avokues të grave në biznes; dhe Krijimi i strategjisë komunale për fuqizimin e pozitës së gruas në biznes.

